

**URDHËR**  
**Nr. 190, datë 29.6.2020**

**PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR. 327, DATË 29.8.2019 “PËR MIRATIMIN  
E RREGULLORES MBI PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE TË PËRBASHKËTA TË  
AJRIT DHE DISPOZITAT OPERACIONALE NË LIDHJE ME SHËRBIMET DHE  
PROCEDURAT NË LUNDRIMIN AJROR”**

Në zbatim të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës; të nenit 9, pika 1(d), të ligjit nr. 10040, datë 22.12.2008, “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në përputhje me ligjin nr. 9658, datë 18.12.2006, “Për ratifikimin e marrëveshjes shumëpalëshe ndërmjet Komunitetit Evropian dhe shteteve anëtare të tij, Republikës së Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, Republikës së Maqedonisë, Republikës së Islandës, Republikës së Malit të Zi, Mbretërisë së Norvegjisë, Republikës së Rumanisë, Republikës së Serbisë dhe Misionit Administrativ të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovës, për krijimin e një zone të përbashkët të aviacionit evropian”,

**URDHËROJ:**

Në urdhrin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 327, datë 29.8.2019, “Për miratimin e rregullores mbi përcaktimin e rregullave të përbashkëta të ajrit dhe dispozitat operationale në lidhje me shërbimet dhe procedurat në lundrimin ajror”, bëhet ndryshimi si më poshtë:

1. Pika 3 ndryshohet me këtë përmbajtje:

“3. Ky urdhër do të zbatohet pas datës 31 dhjetor 2020.”.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË**  
**Belinda Balluku**